



Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo

Agjencia kundër Korrupsionit
Agencija protiv Korrupcije / Anti-corruption Agency

RAPORT MBIKËQYRJA E PRANIMIT TË DHURATAVE 2011

PRISHTINË, SHTATOR 2012

Katalogu i dhuratave

Bazuar në Ligjin nr. 04/L-050 Institucionet publike janë të obliguara Të gjitha dhuratat e pranuar dhe vlera e tyre përkatëse, si dhe emrat e personave që kanë dhënë dhuratën, duhet të regjistrohen në regjistrin e dhuratave nga personi zyrtar që përcaktohet nga Agjencia dhe që mbahen nga institucioni, në të cilin personi zyrtar ushtron detyrën. Kopjet e katalogëve duhet t'i dërgojnë në AKK jo më vonë se më 31 mars të vitit në vijim.

Dorëzimi i katalogut të dhuratave

Agjencia kundër Korrupsionit, ka pranuar nga 12 (dymbëdhjetë) institucione, njoftimet lidhur me pranimin e dhuratave, ndërsa 18 (tetëmbëdhjetë) institucione tjera kanë deklaruar se nuk kanë pranuar dhurata gjatë vitit 2011.

Institucionet të cilat kanë deklaruar se kanë pranuar dhurata

Institucionet të cilat kanë dorëzuar kopjet e katalogut të dhuratave gjatë këtij viti për vitin 2011 janë: Presidenca 16 dhurata protokollare; Zyra e Kryeministrit 1 dhuratë të rastit; Ministria e Punëve të Brendshme 5 dhurata të rastit; Ministria e Punëve të Jashtme 3 dhurata 2 protokollare dhe 1 e rastit; Ministria e Integritimit Evropian 1 dhuratë të rastit; Gjykata Kushtetuese 6 dhurata protokollare; Institucioni i Avokatit të Popullit 2 dhurata të rastit; Trusti i Kursimeve Pensionale 25 dhurata të rastit; Agjencia Kosovare e Pronës 3 dhurata të rastit; Komuna e Prishtinës 7 dhurata 5 protokollare dhe 2 të rastit; Komuna e Skenderajt 5 dhurata protokollare; Komuna e Graçanicës 2 dhurata protokollare.

Të dhënat e specifikuar lidhur me katalogët e dhuratave sipas institucioneve që i kanë dorëzuar kopjet e katalogut në AKK, janë të paraqitura në tabelën në vijim.

Institucionet	Protokollare	Rastit	Numri i dhuratave të deklaruara
Presidenca	16	00	16
Zyra e Kryeministrit	00	01	01
MPB	00	05	05
MPJ	02	01	03
MIE	00	01	01
Gjykata Kushtetuese	06	00	06
Avokati i Popullit	00	02	02
Trusti i Kursimeve Pensionale	00	25	25
Agjencia Kosovare e Pronës	00	03	03
Komuna e Prishtinës	05	02	07

Komuna e Skenderajt	05	00	05
Komuna e Graçanicës	02	00	02
TOTALI	36	40	76

Tabela 01: Pasqyrë e përgjithshme mbi deklarimin e dhuratave.

Nga institucionet tjera nuk kemi pranuar përgjigje lidhur me pranimin ose jo të dhuratave edhe për kundër kërkesës sonë për të na njoftuar.